

STRATEGJIA E SHPËRNDARJES NË ASK

Hyrje

Shpërndarja paraqet efikasitetin e ofrimit të shërbimeve për personat fizik dhe juridik sipas nevojave të tyre. Ajo i referohet të gjitha aktiviteteve të statistikave zyrtare, që përfshijnë prezantimin e rezultateve të statistikave zyrtare, si dhe mjetet dhe metodat e sigurimit të qasjes në rezultatet dhe bazën metodologjike. Shpërndarja varet nga strategjia zyrtare, specialistët e kualifikuar, dhe mbështetja teknike.

Strategjia e shpërndarjes së të dhënave statistikore të ASK = Përdoruesi i kënaqur

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është organizatë shtetërore administrative, autoritet qendror, prodhues kryesor, shpërndarës dhe koordinator i sistemit të statistikave zyrtare të Republikës së Kosovës, që vepron në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me Ligjin e Statistikave Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 04L-36.

Sipas Ligjit është detyrë e ASK-së të mbledhë, përpunon dhe shpërndanë të dhëna për qëllime statistikore për _____ekonomike, sociale dhe kushtet e përgjithshme në Kosovë, si dhe i sigurojnë Kosovës përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare.

Sipas Ligjit, është detyrë e ASK-së të mbledhë, të përpunoj dhe publikojë të dhëna mbi ekonominë dhe kushtet e jetesës në Kosovë.

Strategjia bazohet në praktikat më të mira evropiane për diseminimin. Parimet e diseminimit zbatojnë Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane. Objektivat kryesore janë:

1. ASK-ja të jetë burimi i preferuar i fakteve statistikore për Kosovë
2. Të ofrohen fakte dhe statistika për debate publike në Kosovë
3. Të përmirësohet ndërveprimi / dialogu me përdoruesit

Përveç objektivave të cekura më lartë, Strategjia shpërndarjes do të mbështesë arritjen edhe të objektivave tjera të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane që do zhvillohen në përputhje me rrethanat.

1. ASK-ja të jetë burimi i preferuar i fakteve statistikore për Kosovë

ASK është institucioni statistikor i autorizuar për aktivitetet statistikore zyrtare në Republikën e Kosovës, dhe prodhuesi i shumicës së aktiviteteve statistikore. ASK nuk është prodhuesi i vetëm i aktiviteteve statistikore ku si bartës të caktuar të statistikave zyrtare përveç ASK në Republikën e Kosovës janë edhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Ministria e Financave si dhe institucionet e tjera të autorizuar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të caktuara me ligj.

ASK është institucioni kryesor ku shfrytëzuesit e ndryshëm, bota e biznesit, ministritë, qeveria dhe publiku në përgjithësi duhet të kërkojnë statistika për vendimet e tyre. Përveç kësaj, ASK-ja do të jetë edhe qasje drejt statistikave evropiane dhe statistikave të tjera zyrtare ndërkombëtare.

Të gjitha të dhënat statistikore të publikuara nga ASK konsiderohen statistika zyrtare, pavarësisht nga metoda e shpërndarjes (publikime të shtypura, internet, media elektronike, përpunim i përshtatur).

1.1. Të dhëna relevante dhe të besueshme

Shpërndarja e statistikave zyrtare bëhet në pajtim të plotë me parimet statistikore, sipas nenit 3 në Ligjin e Statistikave Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 04L-36. e në veçanti në lidhje me ruajtjen e fshehtësisë statistikore dhe sigurimin e qasjes së barabartë sipas parimit të paanësisë.

Shpërndarja statistikave zyrtare duhet të jetë objektiv, neutral, i paanshëm dhe transparent. Shpërndarja e statistikave zyrtare është relevante, në kohën e duhur, dhe bazohet në publikime të përpikta.

ASK-ja garanton konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave statistikore për njësitë raportuese që i publikon

Të dhënat statistikore të mbledhura nga njësitë raportuese publikohen pa identifikues të cilat mund të jenë të lidhura direkt ose indirekt me personin fizik ose juridik që përfaqëson njësinë raportimit në ASK-së. Të gjitha të dhënat që publikon ASK-ja dhe të dhënat e prodhuara me kërkesën e përdoruesve shprehen në formë të përmbledhur.

Privatësia dhe identiteti i ofruesve të të dhënave (ekonomitë familjare, ndërmarrjet, administratat dhe të intervistuarit e tjerë) janë konfidenciale dhe të dhënat, që ata ofrojnë, përdoren vetëm për qëllime statistikore, si dhe në raste të veçanta që janë të përcaktuara me Ligjin e statistikave zyrtare.

1.2. Njoftimi për gabimet dhe keqpërdorimet

Gabimet në statistikën korrigjohen sa më herët që është e mundur, dhe kjo bëhet e ditur në webfaqen e ASK-së.

Përdoruesit dhe abonuesit informohen për gabimet në faqen kryesore. Në webfaqe publikohen komunikatat e reja për shtyp duke sqaruar gabimin. Korrigjimi i gabimeve rregullohet sipas procedurave të shkruara. Këto procedura miratohen nga Menaxhmenti i ASK-së.

Për sa i përket publikimeve në letër, korrigjimet duhet të merren në konsideratë në rast të gabimeve serioze dhe nëse është e mundur, duhet të informohen përdoruesit.

Nëse ka ndonjë keqpërdorim apo keqinterpretim të statistikave në media, ASK-ja duhet të ndërmarrë veprime. Procedurat për veprimet e tilla mund të gjenden në politikën e ASK-së për media dhe shtyp.

1.3. Afati kohor & Përpikëria

Bartësit e statistikave zyrtare janë të detyruar ta hartojnë dhe ta bëjnë publike kalendarin e publikimeve statistikore.

Kalendari i publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit, si dhe në format të printuar për përdorim të brendshëm. Të gjitha publikimet vjetore duhet të dorëzohen në sektorin e desiminimit së paku 3 ditë para datës së publikimit, ndërsa publikimet tremujore dhe mujore dorëzohen së paku një ditë para datës së publikimit. Publikimet publikohen në përputhje të plotë me kalendarin e publikuar, dhe janë në dispozicion në faqen e internetit pikërisht në orën 14⁰⁰ në datën e caktuar. Varësisht nga zhvillimi i kapaciteteve në ASK, ora e standarde e publikimit mund të jetë më e hershme.

Çdo vonesë e publikimit të të dhënave nga plani në Kalendar do të njoftohet paraprakisht në faqen e internetit, do të jepet arsyeja për vonesën e publikimit si dhe data se kur pritet të publikohet ky publikim.

ASK përpiket të dhënat në publikime dhe ASK Data ti publikojë në të njëjtën kohë. Afatet kohore dhe përpikëria matet kundrejt njoftimit për shtyp.

1.4. Dokumentimi i saktë (metadat)

Statistikat zyrtare gjithmonë shpërndahen me metadat dhe shpjegimet përkatëse për të evituar keqinterpretimet dhe keqpërdorimet.

Përdoruesit informohen për cilësinë e produkteve statistikore sipas kritereve të cilësisë të Statistikave Evropiane.

Dokumentimi i metodologjisë përfshin informacionet mbi burimet dhe metodat e mbledhjes së të dhënave, si dhe mbulueshmërinë dhe përkufizimet e përdorura në produktet statistikore. Ato mund të gjenden në webfaqe dhe të gjitha publikimet statistikore dhe tabelat në ASKData do të kenë linkun përkatëse për tek to. Informacionet mbi metodologjinë përpilohen sipas standardeve të Eurostat-it, ESMS.

1.5. Krahasueshmëria ndërkombëtare

Statistikat e shpërndara duhet të jenë koherente dhe të krahasueshme, sipas parimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare.

Për të kuptuar fenomenet sociale dhe ekonomike me ndihmën e statistikave, është e rëndësishme që statistikat të përmbajnë seri të gjata kohore dhe krahasime përgjatë grupeve dhe vendeve me të cilat mund të krahasohet me seri të gjata kohore të zyrave të tjera statistikore. Ndërprerjet e rastit mund të ndodhin nga një periudhë në tjetrën, dhe për këtë arsyeje është shpesh e nevojshme që të krahasohen disa vite (seri të gjatë kohore) për të parë tabloun e gjerë të zhvillimit. Edhe pse mund të ketë në fusha të ndryshme ndërprerje në seritë kohore, megjithatë ASK-ja përpiket që të prodhojë shifra të rishikuara aty ku është e mundur, dhe të plotësojë udhëzimet metodologjike për të shpjeguar ndërprerjen në seri kohore dhe që të prezantojë metodologji të re për të dhënat .

2. Të ofrohen fakte dhe statistika për debate publike në Kosovë

2.1. Relevanca dhe afatet kohore

Ofrimi i fakteve të dhënave statistikore në kohë për debate publike është shumë e rëndësishme për ASK. Po ashtu ASK-ja do të shqyrtojë mundësitë e reduktimit në kohë për prodhimin dhe shpërndarjen e të dhënave paraprake, në mënyrë që nevojat e përdorueseve për të dhëna statistikore të plotësohen me kohë .Statistikat zyrtare duhet të jenë të rëndësishme për përdoruesit dhe të përmbushin nevojat e tyre. Të dhënat statistikore duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të mbulojnë nevojat që bien në kuadër të fushave të veçanta statistikore.

Afatet kohore dhe përpikëria – statistikat zyrtare duhet të shpërndahen në kohën e duhur në raport me periudhën e afatit kohor, e cila në asnjë rast nuk duhet të jetë më e gjatë se koha reale për të mbledhur, përpunuar dhe publikuar të dhënat statistikore dhe nevojat e përgjithshme të shoqërisë si një tërësi.

2.2. Qasja dhe qartësia

Statistikat zyrtare duhet të paraqiten në formë të qartë dhe të kuptueshme, të shpërndara në mënyrë të përshtatshme ku të gjithë përdoruesit duhet të kenë qasje të barabartë te statistikat zyrtare në webfaqe. Kjo do të thotë që të dhënat e publikuara të statistikave zyrtare duhet të paralajmërohen paraprakisht dhe që asnjë kategori përdoruesish të mos ketë qasje në statistikat zyrtare përpara se ato të publikohen.

ASK do të ofroj edhe qasje sa më të lehtë në të dhëna statistikore zyrtare për përdoruesit ku të dhënat statistikore të jenë lehtë të kuptueshme edhe për ata përdorues të cilët nuk kanë asnjë njohuri paraprake

mbi statistikak pavarësisht nga përgatitja e tyre arsimore dhe profesionale ata do të mund të gjejnë dhe kuptojnë statistikak të cilat janë relevante për jetën e tyre të përditshme.

Sa i përket Qartësisë së të dhënave ASK i referohet përshkrimit dhe metodologjisë së përdorur për llogaritjen e të dhënave në mënyrën më të lehtë dhe të qartë për përdoruesit ku nëpërmjet metadatave të standardizuara ASK siguron se statistikak janë të kuptueshme.

Duke pasur parasysh numrin në rritje të përdoruesve të të dhënave statistikore të cilët po e përdorin internetin si mjet dhe si burim të të dhënave, të dhënat statistikore në web faqen e ASK-së janë të publikuara në tri gjuhët shqipe, serbe dhe angleze.

2.3. Platformat

ASK-ja përdor platforma ose produkte të ndryshme për të arritur tek përdoruesit e vet. Prioritare do të jetë, ASK Data, shpërndarja elektronik në internet dhe mediat sociale si Facebook. Publikimet e shtypura do të jenë me më pak prioritet. Të gjitha statistikak zyrtare gradualisht do të jenë në dispozicion në ASK Data, dhe deri në fund të vitit 2017 të gjitha të dhënat e publikuara do të jenë në dispozicion në këtë platformë. askdata.rks-gov.net

Publikimet që do të shtypen do të jenë publikime gjithëpërfshirëse si Vjetari Statistikor apo ndonjë publikim që ka ndonjë rëndësi të veçantë. Publikimet do të publikohen edhe në formatin PDF. Disa grupe përdoruesish mund të arrihen përmes mediave sociale. Prandaj, ASK-ja është aktive në edhe në media sociale.

Në vitin 2016 është bërë lancimi i Web faqes së re të ASK-së ku përdoruesit do të kenë qasje më të lehtë në të dhëna statistikore.

2.4. Gazetarët dhe mediat

Shumë përdorues informohen për statistikak vetëm përmes mediave. Prandaj, duhet kushtuar vëmendja e veçantë gazetarëve dhe mediave të lajmeve. Mediat e lajmeve informohen aktivisht për publikimet e reja relevante statistikore. Përveç kësaj, ASK-ja ndërmer aktivitete për prezantimin dhe shpjegimin e publikimeve statistikore për shtypin dhe mediat elektronike të lajmeve, si dhe kur konsiderohet relevante, mbahen konferenca për shtyp dhe takime me mediat. Ndërveprimet e ASK-së me mediat e lajmeve përshkruhen në politikën e ASK-së për media dhe shtyp.

Përdorues të ndryshëm kanë nevojë për lloje të ndryshme statistikash. ASK-ja ofron një numër të madh produktesh dhe shërbimesh.

Është esenciale për ASK-në që të siguroj qasje të barabarta me informatat statistikore për të gjitha kategoritë e përdoruesve. ASK-ja ofron informata jo vetëm për ministritë, por edhe për përdorues tjerë qendror dhe kompani të mëdha, si dhe për publikun në tërësi. Duhet të rritet interesi në mes të përdoruesve, të cilët kanë detyra socio-ekonomike si dhe detyra të tjera në lidhje me statistikak, siç është administrata lokale, shkollat, grupet e ndryshme etnike etj. Kjo ka të bëjë me imazhin e ASK-së dhe përpjekjet e saj që të konsiderohet si e pavarur dhe prodhuese e paanshme e statistikave dhe kontribues i procesit demokratik në Kosovë.

Si rregull, grupe të ndryshme të përdoruesve kanë nevojë për informata të ndryshme statistikore dhe në raport me këtë nevojë ASK ofron të dhëna themelore, të standardizuara dhe informatat specifike të përdoruesve.

Të kuptuarit e statistikave, apo thënë më shkurt leximi përmes shifrave duhet të përmirësohet. Mënyrat e arritjes së një leximi të përmirësuar statistikor, arrihet duke pasur një dialog të mirë me mediat dhe institucionet arsimore, përmes takimeve dhe intervistave, me fokus grupet me palët e interesuara për të

dhëna statistikore nga ky dialog. ASK-ja do të mbledhë informacionet mbi nevojat dhe kompetencat e grupeve të ndryshme të përdoruesve.

Komunikimi me përdoruesit bëhet me qëllim të të kuptuarit të nevojave të tyre. Arritja e përdorimit të lehtë të produkteve bazohet në Anketat mbi kënaqshmërinë e përdoruesve.

2.5. Vizualizimi

Statistikat e vizualizuara shpesh ofrojnë një pasqyrë më të qartë të të dhënave krahasuar me tabelat, tekstet ose baza e të dhënave. Vizualizimi i të dhënave duhet të bëhet për interes të përdoruesve.

3. Të përmirësohet ndërveprimi / dialogu me përdoruesit

Përdorues të ndryshëm kanë nevojë për lloje të ndryshme statistikash. ASK-ja ofron një numër të madh produktesh dhe shërbimesh. Përdoruesit ndahen si në vijim (jo sipas prioritetit): • institucionet qeveritare • qeveritë lokale • studentët, hulumtuesit dhe institucionet arsimore • mediat e lajmeve • kompanitë • organizatat joqeveritare, asociacionet, fondacionet etj. • përdoruesit e jashtëm dhe organizatat ndërkombëtare • qytetarët e zakonshëm. Përmirësimi i leximit statistikore të popullsisë është një detyrë e rëndësishme. Mënyrat e arritjes së një leximit të përmirësuar statistikor është të paturit një dialog të mirë me mediat dhe institucionet arsimore. Nëpërmjet takimeve dhe intervistave të fokus grupeve me palët e interesuara ASK do të marrin njohuri mbi nevojat dhe kompetencat e grupeve të ndryshme të përdoruesve. Komunikimi me përdoruesit bëhet me qëllim të të kuptuarit të nevojave të tyre. Arritja e përdorimit të lehtë të produkteve bazohet në anketat mbi kënaqshmërinë e përdoruesve.

3.1. Monitoroni përdorimin e statistikave dhe kënaqshmërinë e përdoruesve!

Përdoruesit janë të ndryshëm: kur duam të dimë për nevojat specifike të përdoruesve (p.sh., qasja në metadatat ose të dhënat e rishikuara) ne organizojmë fokus grupe. Analizimi i webfaqes është një mënyrë plotësuese e analizimit të sjelljes së përdoruesve. ASK-ja është duke përcjellë dhe do ta rris këtë monitorim lidhur me përdorimin e statistikave tona nga ana e mediave, i mbledhim citimet në media dhe i ndajmë këto rezultate në baza ditore dhe mujore për të gjithë të interesuarit në organizatën tonë. Kjo bëhet për tu ofruar statisticientëve informacione lidhur me përdorimin dhe interpretimin e publikimeve të tyre.

Kënaqshmëria e përdoruesve monitorohet rregullisht dhe sistematikisht duke e realizuar Anketën mbi kënaqshmërinë e përdoruesve. Kjo anketë do të zhvillohet edhe këtë vit (2017) në ASK. Po ashtu ASK do të organizoj për herë të parë edhe Anketën e Kënaqshmërinë së Stafit të ASK-së.

Gjithashtu, analizohen të dhënat mbi përdorimin e statistikave. Anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve bëhet me qëllim të planifikimit të veprimeve në të ardhmen që përdoruesit tonë të jenë sa më të kënaqur me produktet statistikore. Organizohen takime të rregullta të përbëra nga përdoruesit kryesorë dhe ofruesit e të dhënave ku diskutohen aktivitetet dhe nevojat e tyre.

Përmes analizimit të webfaqes ne studiojmë aktivitetin e përdoruesve në webfaqe dhe marrim parasysh kërkimet e tyre në faqen tone kur përditësojmë fjalët kyçe dhe indeksat për 'kërko' përmes Google analitic.

3.2 Komunikimi me përdorues

ASK-ja komunikon rregullisht me grupe të caktuara përdoruesish për të diskutuar pritshmëritë e tyre për prodhimet statistikore dhe shërbimet. Në kuadër të kësaj realizohen edhe takime të ndryshme, të cilat shfrytëzohen edhe për t'i informuar përdoruesit për ndonjë ndryshim të planifikuar të statistikave.

Kjo ka rëndësi të veçantë në procesin e plotësimit të kërkesave dhe nevojave të përdoruesve në aspektin e cilësisë dhe sasisë së statistikave zyrtare, që do t'i publikojë ASK-ja.

Zyrtarët/et përgjegjës të njësive përkatëse (ata/ato) që punojnë direkt në prodhimet statistikore janë të thirrur të marrin pjesë në debate dhe komunikime publike me media, pasi që qasja e tyre është më e lehtë në të dhëna. Një praktikë e tillë aplikohet edhe në institutet e tjera kombëtare të statistikës.

3.3 Vetëdijësimi

ASK organizon trajnime dhe ngjarje të tjera për të ngritur vetëdijen për ASK-në dhe për rëndësinë e statistikave në përgjithësi tek institucionet qeveritare, studentët dhe bizneset private. Ku një ndër prioritetet e ASK është edhe organizimi i këtyre trajnimeve ne baza vjetore gjithmonë duke pasur parasysh rëndësin e statistikave për zhvillimin e ekonomisë së një shteti.

